




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [kk.rks-gov.net/gjilan](http://kk.rks-gov.net/gjilan), [indo.gjilan@rks-gov.net](mailto:indo.gjilan@rks-gov.net) tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

### Procesverbal

Nga Seanca e IX( nëntë) e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 16.10.2012 me këtë:

### REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të PZHU – “Subqendra – Zhegër”,
3. Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të PRRU “Zabeli-1”,
4. Propozim vendimi mbi qasjen e revidimit PDU ish “Popovica” mbi tunel,
5. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen për transportin e udhëtarëve “Kosovatrans” në Gjilan.
6. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në PPP “Ecohigjiena” (për pjesën publike të KRM “Higjiena”),
7. Ndarja e mjeteve financiare në emër të subvencionit për familjet e Dëshmorëve,
8. Kërkesë për anulimin e vendimit për lejin e mjeteve financiare prej 100€ në emër të kujdesit për familjen e ish punëtorit të SHCK, Nr.01-8033/020 të datës 08.10.2002,
9. Anulimi i vendimit 01.Nr.3374 të datës 30.03.2009, për mbështetjen financiare të kandidatëve që përgatisin disertacionin e doktoraturës.
10. Anulimi i vendimit për lejin e marrjes me qira të hapësirave mësimore për student, 01.Nr.16-16499 të datës 09.02.2012,
11. Propozim vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për raste sociale,
13. Propozim vendimi për uljen e tarifës mbi qiranë për shfrytëzimin e lokalit afarist (Bodrumi-Tombola) në Gjilan
14. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.15.min

Kryesuesi i seancës  
z. Izmi Zeka

Në punimet e seancës së IX (nëntë) morën pjesë:  
Anëtarët e Kuvendit  
Kryetari i Komunës

Drejtorët e drejtorive  
Përfaqësuesi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut  
Përfaqësuesi i OSB-së  
Përfaqësuesi i Forumit Demokratik “Anamorava”  
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile  
Përfaqësuesit e KFOR-it  
Mediet

Seancën e IX ( nëntë) të Kuvendit të Komunës e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive, kryetarin e Komunës dhe përfaqësuesit e OSB-së, KFOR-it, mediet dhe të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët ishin të pranishëm në punimet e seancës së nëntë.

Në vijim kryesuesi kërkoi që të konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e kësaj seance.

#### 1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së nëntë ishin të pranishëm 38 anëtarë të Kuvendit, kurse munguan: Tefik Ibrahim, Elez Muja dhe Selim Selimi

Procesverbali nuk pati vërejtje i cili edhe u aprovua.

Pas konstatimit të prezencës, kryesuesi kërkoi që anëtarët e Kuvendit të deklarohen për rendin e punës?

Sokol Haziri- në këtë Kuvend ka qenë një praktikë e mirë e cila është zbatuar në këtë Kuvend, sepse fillimisht kishim takime konsultative me shefat e grupeve parlamentare të cilat përfaqësohen në Kuvend. Nuk e kam të qartë se çka ka ndodh, por do të ishte mirë që kjo të praktikohet përsëri. Në këto takime konsultoheshim rreth pikave të rendit të punës së seancës së Kuvendit dhe harmonizoheshim 100% për pika të rendit të punës në Kuvend.

Sa po shihet në këtë seancë janë disa pika të rendit të ditës me të cilat kërkohet anulimi i disa vendimeve të cilat për mua nuk janë shumë të paligjshme, por mungon një vendim i cili do të duhej të futej si vendim për t’u anuluar e që është më i paligjshmi, më i keq dhe më i dëmshmi për qytetarët e Gjilanit e që ky Kuvend e ka nxjerr.

Ky vendim është; vendimi për kushtëzimin e qytetarëve të Gjilanit me pagesën e shërbimeve komunale. Këtë vendim ne e kemi kontestuar vazhdimisht dhe besoj se edhe nga grupi i partisë në pushtet ka të tillë, prandaj do të ishte mirë që nëse jo sot, në një nga seancat e radhës të futet si pikë e rendit të punës për të cilin vendim do të rideklrohem.

Një kërkesë tjetër për cilin unë kërkoj përgjigje është ajo se cili është statusi i Ombdus Personit në Zyre të Kryetarit të Komunës ? Në çfarë cilësie qëndron ai aty? Këtë po e lidhi me këtë kërkesë të cilën e kemi bërë në Kuvend të cilit iu kemi drejtuar me këtë kërkesë dhe i njëjti nuk ka marrë guximin që do të duhej ta kishte si institucion i pavarur që ta adresojë çështjen ku duhet?

Do të ishte mirë që ne si anëtarë të Kuvendit të njoftohemi a ka konflikti interesi apo jo, prania e atij institucioni te ekzekutivi si institucion i pavarur i cili do të duhej të ishte jashtë Komunës, sepse ai do të duhej t’i mbrojë interesat e qytetarëve kur ato cenohen nga pushteti.

Arben Mehmeti- ne vazhdimisht kemi kërkuar edhe një pikë të rendit të punës e cila ka qenë dhe është për transmetim të seancave. Është premtimi i dytë publikë të cilin e keni dhënë, por të cilin nuk jeni duke e zbatuar. Ju keni premtuar një gjë të tillë, por kanë kaluar dy seanca dhe ju nuk keni ndërmarrë asnjë hap në këtë drejtim!

Kjo është jo serioze, ne po e përsërisim kërkesën përsëri dhe është mirë që nga seanca e radhës të fillojë ky transmetim dhe është mirë që edhe kësaj radhe kryesuesi të premtojë dhe herën e katërt të realizohet ky premtim.

Gjithashtu edhe ne e përkrahim plotësisht kërkesën e Sokolit që të anulohet edhe ai vendim i paligjshëm i KK të Gjilanit me të cilin kushtëzohen qytetarët për shlyerje të obligimeve për shërbime komunale.

Krahas anulimit të atij vendimi është mirë që të na epet një shkresë nga MPL për të parë se çfarë rekomandime ka dhënë kjo ministri, sepse ju vetë keni pasur obligim për të na njoftuar, por ju i mbani në sirtar ato vendime.

Nën të ndryshme kërkojmë një informatë lidhur me punët që janë duke u bërë në Bibliotekën e qytetit në Gjilan.

Gjithashtu kërkojmë edhe një informatë për mirëmbajtjen verore të rrugëve nga drejtoria përkatëse.

Këto janë kërkesat tona për debat në Kuvend.

Izmi Zeka- unë kërkoj që në seancën e radhës të na sillet një informatë me shkrim edhe për Bibliotekën dhe për mirëmbajtjen verore të rrugëve.

Gjithashtu të gjitha vendimet e MPL-së të cilat MPL- ka sugjeruar që t' i anulohet dhe këtë e ka bërë me shkrim, ne do t' i anulohet.

Kjo vlen edhe për kushtëzime, sepse ne jemi të detyruar t' i anulohet nëse rekomandon ose bie vendim MPL-ja.

Ombdus Personin nuk po kemi mundësi për ta larguar, sepse nuk kanë hapësirë. Është edhe në interes tonin që ai të largohet, sepse ne kemi nevojë shumë për hapësirë për zyrtarët tanë. Ata ende nuk kanë bërë zgjidhje, kurse ne vazhdimisht kemi kërkuar që ata të largohen nga selia e kryetarit të Komunës.

Sokol Haziri- Avokati i Popullit është një institucion i pavarur dhe me kushtetutë e ka buxhetin e vetë. Po të ishte diçka që është humane dhe nuk kanë para do të ishte në rregull, por të njëjtit e kanë buxhetin e dedikuar. Ky është konflikt i thellë i interesit, sepse ky institucion nuk duhet të jetë afër pushtetit.

Izmi Zeka- ne do të bëjmë përpjekje për ta larguar Ombdus Personin nga zyrat e Komunës, kurse iu lus që të deklaroheni se kush është për aprovim të rendit të punës me një plotësim që të epet një informatë për Bibliotekën dhe për mirë mbajtje verore të rrugëve?

Aprovohet rendi i punës me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

## 2. Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të PZHU – “Subqendra – Zhegër”,

Kryesuesi i Kuvendit lidhur me këtë pikë të rendit të punës fjalën ia bartë drejtores së DUMM.

Bahrie Mahmuti- Drejtoria e Urbanizmit duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e saj ka inicuar këtë propozim-vendim për qasjen e hartimit të planit rregullues urban sub-qendra Zhegër. Në vijim të fjalës së saj drejtoresha dha sqarime detale të cilat sqarime anëtarët e Kuvendit i kanë në materialin e seancës.

Florinë Zymberi- unë mendoj se hartimi i këtij plani zhvillimor është me rëndësi për të ardhmen e kësaj pjese, sepse ndihmon në rregullimin e hapësirës, rregullim të tokës ndërtimore, ruajtjes së tokës bujqësore, mandej ruajtjes së pyjeve, zhvillimit të infrastrukturës dhe zhvillim të kushteve të qëndrueshme për këtë trevë e cila do t' i qëndrojë kohës. Ky Plan në Komitetin e Urbanizmit është rekomanduar për KK, prandaj mendoj se duhet ta aprovoni këtë propozim-vendim?

Sokol Haziri- edhe grupi i AAK-së e mbështet në parim këtë propozim-vendim dhe të gjitha ato që u than gjerë me tani duhet të jemi të kujdesshëm që të zbatohen në pajtim me Ligjin për planifikim hapësinor dhe akte të tjera normative.

Ramiz Ramadani- hartimin e planit Zhvillimor urban, sub- qendra Zhegër ne e shohim jo vetëm si mundësi të një organizmi më të mirë hapësinor, por edhe si një mundësi të ruajtjes së tokës bujqësore e cila sidomos në zonat rurale është duke u degraduar.

Ashtu si i dha sqarimet drejtoresha konsiderojmë se kjo zonë ka interferime të drejtpërdrejta në kufi me Republikën e Maqedonisë dhe Serbisë, prandaj kërkojmë që një vëmendje e veçantë gjatë planifikimit t' i kushtohet sidomos objekteve përcjellëse në pikat kufitare, sepse ato janë mundësitë e zhvillimit ekonomik të kësaj zone.

Ne gjatë draftimit publik do ta japim kontributin tonë, por si propozim-vendim ne i japim përkrahje të plotë.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesi kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës.

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të PZHU – “Subqendra – Zhegër”, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit, nuk pati kundër as abstenime

3. Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të PRRU “Zabeli-1”,

Bahrie Mamuti- drejtoresha e DUMM i dha sqarimet lidhur me këtë propozim-vendim, por anëtarët e Kuvendit e kanë arsyetimin me shkrim në materialin e seancës.

Florina Zymberi- në këtë lagje jemi mjaft të ballafaquar me probleme të natyrës së komplikuar urbane, sepse kjo lagjeje është ndërtuar thuajse në mënyrë të egër dhe pa ndonjë plan paraprak. Tash jemi të obliguar që të ofrojmë një shërbim për këtë pjesë, por është vështirë të hartohet një plan rregullues, por më mirë vonë se kurrë. Duhet të shpëtohet aq sa mund të shpëtojmë dhe të krijojmë një rregull urban për këtë lagjeje.

Unë kërkoj që ta aprovoni këtë propozim-vendim?

Abdyl Aliu- para dy ose tri seancave ne e kemi pasur aprovimin e Kornizës buxhetore afatmesme dhe aty gjatë shtjellimit të materialit në asnjë vend nuk ka qenë i paraparë “Zabeli i Sahit Agës” për investime deri më 2016. Unë në atë rast kam shprehur

shqetësimin tim në emër të qytetarëve të Zabelit, sepse nuk ishte paraparë as Plani rregullues urban. Mirëpo kur e pash në rend të punës isha i kënaqur, sepse vërejtja e ime paska qenë me vend dhe në emër të këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë propozim-vendim dhe çdo punë që bëhet sipas planifikimit. Kësaj ia bashkëngjisim edhe kërkesën për pjesën e mbetur të Zabelit që të hartohet një plan i tillë, por edhe në të gjitha pjesët ku nuk ka plan rregullues urban. Ju faleminderit për durim!

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me këtë pikë, kurse kryesuesi i Kuvendit kërkon që deklarohen anëtarët e Kuvendit për aprovim të këtij propozim-vendimi

Aprovohet pika 3 e rendit të punës: Propozim vendimi mbi qasjen e hartimit të PRRU “Zabeli-1”, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit, nuk kishte kundër as abstenime.

#### 4. Propozim vendimi mbi qasjen e revidimit PDU ish “Popovica” mbi Tunel,

Bahrie Mamuti – edhe për këtë pikë të rendit të punës sqarime dha drejtoresha e urbanizmit i cili arsyetim iu është dorëzuar anëtarëve të Kuvendit me shkrim.

Jashar Jashari- unë pasi i takoj kësaj pjese të qytetit në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së përkrahim planin e zhvillimit urban “Popovica” mbi Tunel.

Florina Zymberi- duke u bazuar në planet mëhershme detale dhe planet zhvillimore në këtë pjesë, por që nuk janë respektuar nga qytetarët është ndërtuar një ambient jo i mirë urban! Për këtë arsyeje mendoj se është e nevojshme ndërhyrja dhe revidimi i panit rregullues urban, duke theksuar se do të jetë mjaft i vështirë, por që ia vlen të bëhet kjo për të mirën e qytetarëve dhe Komunës në përgjithësi.

Duhet të krijohet një mentalitet për një sjellje të mirë ndaj këtyre rregullave urbane.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesi kërkon që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës.

Aprovohet pika 4 e rendit të punës: Propozim vendimi mbi qasjen e revidimit PDU ish “Popovica” mbi tunel, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit, nuk pati kundër as abstenime.

5. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen për transportin e udhëtarëve “Kosovatrans” në Gjilan.
6. Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve në PPP “Ecohigjiena” (për pjesën publike të KRM “Higjiena”),

Izmi Zeka- edhe në takimin e KPF-së dhe në seancën e kaluar e kemi debatuar dhe e kemi thënë se një propozim e ka AKR dhe një LDK. Mirëpo këtu janë dy propozime, një për Higjienën dhe një për Kosovatransin. Unë kam kërkuar që opozita LDK dhe AAK të propozojnë LDK për Higjienë, kurse AAK për Kosovatrans ose të kundërtën. Këto dy grupe të merren vesh në mes vete.

Mirëpo së pari të na vijë propozimi nga AKR.

Arben Maliqi- ne e kemi pasur një takim dhe i kemi dy emra të cilët do t' i sjellim në ndërkohë.

Arben Mehmeti- duhet sqaruar se kjo është e rregulluar me ligjet aktuale në fuqi që përbërja e çdo trupi që krijohet në këtë Kuvend, ajo duhet të jetë krahas prezencës në këtë Kuvend. Ju si grup i PDK-së këtë të drejtë e keni bartë te AKR-ja, por si grup i barabartë në këtë Kuvend, LDK kërkon që të jetë e përfaqësuar në dy komisione.

Në të kundërtën ne nuk e bartim këtë të drejtë askund tjetër dhe nuk jemi pjesë e këtyre trupave nëse nuk respektohet obligimi ligjor i cili del nga LVL. Ky është çelës politik dhe ligjor dhe e jona është që të përfaqësohemi në të dy trupat.

Izmi Zeka- ne kemi desh që në komisione t' i përfaqësojmë të gjithë

Qemajl Mustafa- ne duhet ta sqarojmë qëndrimin e Arbenit. Me Ligjin e ndërmarrjeve publike dy nga emrat shkojnë nga Kuvendi, kurse një emër i tretë shkon nga kryetari i Komunës për këtë komision të aksionarëve të të dy ndërmarrjet. Nuk ka këtu çelës politik është marrëveshje politike si të merremi vesh? Ne jemi marrë vesh që të shkojë nga grupet e mëdha dhe nga koalicioni të shkojë një dhe një nga opozita dhe është çështje e juaja të dy grupeve në opozitë si merreni vesh? Nëse ju merreni vesh që njëri t' i takojë LDK-së dhe njëri AAK-së ajo është manifestim i tolerancës brenda opozitës.

Për ndryshe nëse ju si grup nëse mendoni se si grup i madh mendoni se dy vendet iu takojnë juve, atëherë i gëzofshi! Mirëpo edhe kjo është tolerancë, kur ne i mundësojmë dy emra nga opozita, është tolerancë e skajshme dhe e domosdoshme në këtë Kuvend pa të cilën nuk mund të lëvizim mirë dhe në harmoni.

Elisah Ymeri- unë sa për sqarim kam dëshirë ta di se cili ligj e thotë se këto komisione duhet të jenë të gjitha partive? Unë sa për sqarim po e theksoj se është gatishmëri e jona e KK dhe e Qeverisë Komunale, që t' i inkorporojë të gjitha partitë politike në komisione, ndërsa këtë ne mund ta bëjmë edhe vetë. Kjo është vullnet i joni, sepse me ligj nuk është e theksuar që këto komisione të jenë nga të gjitha partitë politike, kurse trupat e Kuvendit duhet të jenë nga të gjitha partitë politike.

Arben Maliqi- unë nuk dua të polemizojë me homologun tim, por do t' i tregoj qartë se AKR është subjekt i pavarur e ka kryesinë e vetë i ka organet e veta dhe AKR nuk është as PDK as LDK, por është AKR. Nuk është etike nga ana e homologut tim që të shprehet ashtu!

Sokol Haziri- unë pajtohem me disa që e thanë se ligji nuk e përcakton që partitë politike të marrin pjesë dhe është çështje e Kuvendit për të zgjedh dy anëtarë për bordet përkatëse dhe ato do të duhej të ishin profesionistë të lëmive përkatëse që me njohuritë tyre të na sjellin të mira ndërmarrjeve dhe të kontribuojnë në këtë drejtim.

Unë iu falënderoj për këtë gatishmëri të tuajën që t' i ofrohet edhe opozitës ndonjë anëtarë, është një gjest i mirë dhe nuk dua ta refuzojë këtë. Ne do të marrim pjesë në njërën nga kompanitë në Higjienë apo Kosovatrans dhe jemi të gatshëm që të dërgojmë një ekspert i cili do të punojë drejtë dhe me profesionalizëm. Lidhur me këtë nuk kemi pasur kontakte me LDK-në dhe nuk kemi biseduar, por besoj se nuk do të këtë ndonjë problem lidhur me këtë për t' u dakorduar.

Arben Mehmeti- po e sqaroj ajo se ligji i parasheh që dy anëtarë të caktohen nga KK dhe një e cakton kryetari. Kjo është me Ligjin mbi ndërmarrjet publike, por përkundrazi “Ecohigjiena” nuk është më ndërmarrje publike, prandaj kjo tash rregullohet me Ligjin mbi shoqëritë e kufizuara dhe këtu ndryshon forma. “Ecohigjiena” nuk është më ndërmarrje publike komunale, sepse 51% të aksioneve i ka partneri privat dhe e ka kaluar tretmanin e ndërmarrjes publike. Kjo është e përcaktuar edhe me Ligj mbi shoqëritë e kufizuara. Mirëpo pjesën e publike e cakton KK, por sa i cakton do të ketë dilema edhe me partnerin privat, sepse edhe ai mund të thotë pse Komuna tre anëtarë, kurse ai duhet t’ i bëjë katër. Këto janë probleme të cilat ka qenë desh të rregullohen në marrëveshje në mes të Komunës dhe “Ecohigjienës”. Kjo është trup e Kuvendit dhe në mënyrë strikte parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës së Gjilanit që nëse dy anëtarë kërkohen ata duhet të jenë nga forcat më të mëdha, por nëse ajo e bartë atë përgjegjësi me marrëveshje, ajo është çështje tjetër. Me ligj është kështu, sepse 14 këshilltarë jeni ju PDK, 14 jemi ne si LDK. Ne si LDK me 14 këshilltarë duam të jemi të përfaqësuar në dy komisione. Nëse ju e konsideroni si aspekt teknik mund ta realizoni këtë, por ka mekanizma të tjerë të cilat do ta shqyrtojnë këtë rast.

Izmi Zeka- ju mund të vendosni, jeni forca e parë e opozitës dhe është çështja e juaj si vendosni. Është mirë që ta bëni një konsultë me AAK-në për t’ i ndarë këto dy vende.

Sokol Haziri- unë shpresova tek partnerët opozitar, por paskam gabuar. Unë nuk heq dorë nga qëndrimi që AAK të ketë përfaqësim në njërin nga kompanitë publike në komisionet përkatëse të aksionarëve dhe ky është qëndrim definitiv i yni, me ose pa marrëveshje me dike. Unë propozoj që propozimi të hidhet në votim krahas propozimeve të tjera, por sot nuk e kemi emrin, por mund ta votojmë si vend i rezervuar.

Leonora Bunjkau- kur është fjala për koalicion edhe ne si G-3 jemi të tillë, prandaj edhe G-3 mund të përfaqësohet në këto kompani me një kandidat.

Izmi Zeka- unë jam për atë që një anëtarë ta ketë AKR, një LDK sipas dëshirës së saj, kurse një anëtar t’ i mbetet AAK-së.

Sokol Haziri- unë nuk e di pse AAK ka nevojë të kërkojë lëmosh prej dikujt. Ne e them qartë qëndrimin tonë politik dhe në këto gjëra vendos Kuvendi dhe qëndrimi i ynë është definitiv.

Qemajl Mustafa- kanë të drejtë edhe G-3 dhe AAK si grupet e tjera politike për të propozuar shumë emra dhe të them ashtu të maltretohet Kuvendi për të votuar për secilin emër dhe kush merr më së shumti vota është ai i cili rreshtohet atje deri te numri dy. Mirëpo ne deshëm ta bëjmë këtë që të kalojë me harmoni, sepse ky komision duhet të jetë komision stabil dhe jo pa një analizë kemi propozuar një anëtar nga AKR. Propozimet që vijnë nga kryetari vijnë në Konsultim me degën e PDK-së në Gjilan dhe kjo është shumë e natyrshme. PDK e ka një propozim që vije nga kryetari i Komunës AKR është ajo pjesa tjetër dhe një nga opozita. Do të duhej që opozita të merret vesh, por pasi Sokoli nuk po heq dorë, po detyrohet Kuvendi për të votuar për secilin propozim. Unë kisha kërkuar që të jeni tolerant.

Ne jemi tolerant që dy anëtarë të vijnë nga opozita, nga një në secilin komision dhe ju grupet opozitare duhet të merreni vesh.

E bëjmë një pushim prej 5 minutave, merruni vesh dhe konsultohuni se apo i ndani apo jo? Unë po e them qëndrimin tim se nëse nuk merreni vesh do të duhej t' i takojnë grupit të madh opozitar.

Kryesuesi jep 5 minuta pushim në mënyrë që LDK dhe AAK të gjejnë gjuhë të përbashkët.

Pas një pushimi seanca fillon punimet.

Sadudin Berisha- unë po filloj nga fjala e fundit e kryetarit i cili tha se duhet të ekzistojë vullneti dhe pëlqimi politik për përfaqësim politik të trupave të ndryshme që dalin nga Kuvendi i Komunës dhe logjika e lobimit. Unë mendoj se me logjikë të tillë nuk mund të funksionojë asnjë nivel i organizmit të pushteteve në çdo nivel të saj dhe më së paku te pushtet të cilët janë të zgjedhura me votë të lirë të qytetarit.

Sipas një logjike të tillë asnjëherë dhe në asnjë moment grupimet opozitare politike, pavarësisht numrit të tyre nuk do të mund të jenë të zgjedhura në asnjë prej trupave të caktuara. Mbi bazën e kësaj çdo vendim që sillet në këtë Kuvend dhe në kuvende tjera në përfaqësim respektohet çelësi i përfaqësimit nga grupimi i parë politik më i madh, grupi i dytë dhe radhazi grupet e tjera politike.

Pasi këtu i kemi dy kompani të cilat duhet t' i kenë përfaqësuesit e tyre në bordet e tyre vetëm me dy vende që duhet të zgjedhën në KK, detyrimisht përfaqësimi i çelësit të grupimeve politike duhet të respektohet. Në këtë rast është grupimi i parë politik PDK, me 14 anëtarë, por pasi që është parti në pushtet, kurse grupimi i dytë është LDK dhe mbi bazën e kësaj dhe çelësit të përfaqësimit të qytetarëve, detyrimisht nga dy vende iu takojnë grupimeve politike. Sikur të do kishte numër më të madh të zgjedhjeve për këto dy raste, atëherë do të vijë çelësi tjetër. Mirëpo lobimet dhe me këso lloj përfaqësime thjeshtë janë në kundërshtim me ligjin, sepse mbi bazën e kësaj logjike, atëherë grupimi i parë opozitar politik do të jetë gjithmonë i sfiduar dhe kurrë i përfaqësuar dhe do të përjashtohet vullneti i votuesve të atyre grupimeve politike opozitare më të mëdha.

Mbi bazën e logjikës nuk mund të kemi përfaqësim, është obligim ligjor dhe kjo duhet të respektohet. Në të kundërtën LDK heq dorë nga të gjitha këto që dëshirohen t' i imponohen përmes thirrjes për lobime.

Sokol Haziri- unë nuk pata ndonjë kontakt me përfaqësuesit e LDK-së dhe qëndrimi i im mbetët i qartë, shumë mirë i kristalizuar dhe është çështje e Kuvendit se kë e delegon në këto borde. Kjo nuk është çështje e parive politike, por është e Kuvendit. Unë nuk heq dorë nga ajo që e thash më parë dhe thash vendos Kuvendi.

Përsëri pati debate dhe nuk u gjet ndonjë kompromis lidhur me këtë dhe kryesuesi i Kuvendit kërkon edhe disa minuta pushim derisa të arrihet ndonjë marrëveshje.

Izmi Zeka- pasi që edhe pas kësaj pauze asnjëra palë nuk po lëshon pe, ne vlerësuam që ne të shkojmë në bazë të renditjes ose bazë të fuqisë politike që e kanë në KK.

Kjo ndoshta nuk do t' i konvenojë AAK-së, por LDK nuk po është tolerante, atëherë ne si PDK do ta hedhim në votim që të jenë dy kandidatë të LDK-së.

Sokol Haziri- z. Kryesues ju mund ta thoni vlerësimin juaj, por iu lus ta hidhni në votim edhe propozimin e AAK-së. Si voton Kuvendi është tjetër çështje, por propozimin e AAK-së iu lus ta hidhni në votim dhe nuk keni të drejtë të na injoroni!

Për sqarim po e theksoj se ne nuk i kërkuam dy pozicionet, por ne i kërkuam vetëm një pjesë në pozicion nga të dyja. Është në ndërgjegjen e kolegëve tanë që me ndërgjegje të votojnë.

Leonora Bunjaku- edhe ne kërkojmë që të hidhet në votim edhe propozimi i ynë që një anëtar të jetë nga G-3.

Izmi Zeka- po e fillojmë votimin sipas radhës!

Kush për propozimin që nga G-3 të jetë një anëtar në bord?

Për këtë propozim votuan 6 anëtarë të Kuvendit.

Kush është për “Ecohigjienë” për propozimin e AAK-së?

Për këtë propozim votuan 15 anëtarë të Kuvendit

Kush është për AKR-në

Për këtë propozim votuan 17 anëtarë të Kuvendit.

Kush është për propozimin e LDK-së?

Për këtë propozim votuan 17 anëtarë të Kuvendit.

Në bazë të votimit në këto borde shkojnë PDK, LDK dhe AKR.

## 7. Ndarja e mjeteve financiare në emër të subvencionit për familjet e Dëshmorëve,

Për këtë pikë kryesuesi i Kuvendit ia bartë fjalën kryetarit të Komunës për të dhënë sqarime lidhur me këtë pikë.

Qemajl Mustafa- për arsye se ishte në pushim në atë periudhë Kuvendi, unë i kam ndarë barabarsishtë për dy fëmijë të dëshmorëve ( djalin e Agim Ramadani dhe Abdullah Tahirit) nga 6 mijë euro. Te njëri është nga mallrat dhe shërbimet dhe nuk është subvencionim, por është para publike edhe ajo, prandaj unë iu ftoj që këtë ta aprovoni, sepse Kuvendi dhe trupat e tij ka qenë në pushim.

Mirëpo për të ardhmen jam i mendimit që ne ta marrim një qëndrim për subvencionim të fëmijëve të dëshmorëve, por jo vetëm për këto ceremoni martesore, por ata do të kenë të drejtë ta shfrytëzojnë atë subvencionim si të duan. Atë subvencionim mund ta marrin si bursë për shkollim ose për ndonjë aspekt tjetër për nevojat e tyre.

Tahir Arifi- unë e di që në të njëjtën ditë që ka qenë dasma e Ilir Tahirit i cili është subvencionuar nga Komuna dhe plotësisht pajtohem me këtë, por ka qenë edhe një dasmë tjetër i cili e ka kryer vetë dasmën ( rasti i djalit të Sahit Baftiut) , por i cili nuk e ka ditë se Komuna mund ta ndihmojë. Për këtë po e them se do të ishte mirë që ta kemi parasysh edhe këtë familje.

Qemajl Mustafa- duhet të jetë e barabartë ndihma, përjashtim bëjnë këto dy raste të cilat kanë shkuar në një periudhë kur Kuvendi ka qenë në pushim.  
Do të merremi vesh barbarishtë për të gjitha fëmijët e familjeve të dëshmorëve, sepse nuk janë shumë ata fëmijë. Ne këtë e kthejmë në komitet dhe do të merremi vesh sa do të jetë ajo ndihmë.

Sadudin Berisha- unë në emër të grupit të anëtarëve të Kuvendit jap vlerësime dhe gjykime e të cilin në një mënyrë e kemi dhënë prononcimin tonë edhe në konferencën e fundit për shtyp. Ne jemi dhe do të jemi për herë për mbështetje të familjeve të Dëshmorëve në të gjitha format e ndryshme.

Ne edhe në KPF e kemi thënë se një numër i ligjeve janë miratuar në funksion të mbështetjes së familjeve të dëshmorëve, fëmijëve të tyre edhe mbi bazën e ndihmës financiare, sociale dhe mbi bazën e përparësive në punësim në regjistrim të shkollave të mesme, fakultete dhe në të gjitha sferat e jetës. A janë të mjaftueshme? Sigurisht se jo! Mirëpo nuk mund të pajtohem kur paraja publike ndahet për dasma, gazmende për askënd. LDK sa ka qenë në pushtet ka bërë aksione të ndryshme për t' i ndihmuar në forma të ndryshme për nevojat me prioritet. Njëra prej tyre ka qenë edhe ndërtimi i shtëpisë, sepse iu ka djeg gjatë luftës dhe ka mbetur pa çati me donacione dhe forma tjera. Mirëpo të epen prej parasë publike për dasma dhe veçmas të bëhen ndarje të familjet e dëshmorëve e që i kemi mbi 100 e më tepër familje që kanë pësuar gjatë luftës kujtoj se edhe mungesa e buxhetit është prezent, por është edhe jo ligjore jo kushtetuese dhe e papranueshme.

Për këtë arsyeje LDK kërkon që buxheti të shfrytëzohet për qëllimet për të cilat është grumbulluar. Nëse ka nevojë ka me milionë mënyra për t' i ndihmuar këto familje edhe për këto gazmende me donacione, por jo me para publike. Askujt nuk i takon ajo e drejtë që mbi bazën e vullnetit të caktuar të ndihmojë për dasma askënd.

Qemajl Mustafa- disa herë kemi debatuar këtu se familjet e dëshmorëve nuk duhet t' i lëmë në mëshirën e donatorëve! Ka qenë kërkesë e familjeve për t' i ndihmuar për këto ceremoni të dasmave, prandaj e thash parimisht duhet të merremi vesh për një subvencionim të fëmijëve të tyre e që është një akt tepër simbolik, krahasuar me atë se ato familje çka kanë dhënë! Ku i përdorin është çështje e tyre. Këtu është fjala vetëm për këto dy raste të këtyre familjeve, por më vonë a dëshirojnë në formë të bursave t' i marrin, apo për ndonjë nevojë tjetër familjare, ajo të mbetet punë e tyre. Mos ta banalizojmë se ne po e shpenzojmë paratë publike për ahengje dhe kënaqësi!

Është nevojë familjare ajo, sepse të martohet fëmija i Dëshmorit sikurse i çdo tjetri është nevojë, të organizohet aheng.

Izmi Zeka- i lus anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se kush është për aprovim të ndarjes së këtyre mjeteve financiare?

Aprovohet pika 7 e rendit të punës: Ndarja e mjeteve financiare në emër të subvencionit për familjet e Dëshmorëve, me 15 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan.

8. Kërkesë për anulimin e vendimit për lejimin e mjeteve financiare prej 100€ në emër të kujdesit për familjen e ish punëtorit të SHCK, Nr.01-8033/020 të datës 08.10.2002,

Izmi Zeka- kryesuesi i KK-së për këtë pikë të rendit të punës për sqarim fjalën ia jep drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Xhemajl Salihu- duke pasur parasysh se është kompletuar struktura ligjore në Republikën e Kosovës e cila i rregullon të gjitha segmentet sociale dhe në anën tjetër për shkak të rritjes së kërkesave që në këtë rregullore të përfshihen edhe punëtorët e shëndetësisë dhe arsimit, por edhe në pamundësi financiare për mbulesë të këtij vendimi kërkojmë nga KK që ky vendim të shfuqizohet.

Në vitin 2002 kur është marrë ky vendim atëherë ka qenë i arsyeshëm dhe në një pasues thotë se ky vendim vlen derisa kjo çështje të rregullohet me dispozita ligjore.

Sadudin Berisha- ne me shumë kujdes e kemi analizuar këtë propozim të pozitës për shfuqizim, por pas të gjitha analizave ne kemi vlerësuar se edhe më tej duhet të jetë në fuqi ky vendim dhe më shumë justifikohet qëndrimi i një vendimi të tillë në fuqi për derisa ne kemi mjete buxhetore për diçka që nuk parashih edhe mundësia ligjore. Unë kujtoj se në kuadër të shërbyesve civil hyjnë një kategori e vogël e cila ndihmohet me 100 euro, ne nuk kemi informacion si grupim politik opozitar se cilat janë ato familje që ndihmohen, sa është numri i tyre, sa është kostoja e tyre financiare dhe mandej të vlerësohet dhe të nxirret një vendim për mbetjen në fuqi apo anulimin e tij? Paraprakisht do të duhej të na sillet një raport mbi gjendjen aktuale të ndihmave, numrin e anëtarëve, numrin e familjeve, kostoja vjetore, kostoja mujore dhe më pastaj të flitet për shfuqizim të atij vendimi.

Nëse si i tillë hidhet vendimi në votim pa u dhënë ky vlerësim kujtoj se bëhet një shkelje dhe një dezinformim edhe i anëtarëve të Kuvendit, por edhe të opinionit publik. Kërkesa e jonë është që së pari të nxirret një raport mbi gjendjen e financuar për numër të familjeve, koston vjetore, koston vjetore dhe më pastaj mund të diskutohet për anulimin e këtij vendimi.

Sami Hoxha- unë mendoj se drejtori e dha një arsyetim në këtë aspekt dhe ne kur e kemi marrë këtë vendim me kohë e kemi dhënë një arsyetim se në çastin kur krijohen kushtet ligjore për t' u ndihmuar familjet përkatëse për të cilat e kemi fjalën të kalohet në kompetencën tjetër mos të ndihmohen më prej Komunës.

Drejtori ato arsytetime që i dha, mendoj se i ka të bazuara dhe nuk janë arsytetime sipas dëshirës së tij personale, por janë arsytetime të bazuara në nivelet më të larta shtetërore. Unë mendoj se është propozim i arsyetuar dhe duhet ecur para.

Izmi Zeka- kush për anulim të këtij vendimi ?

Aprovohet pika 8 e rendit të punës: Kërkesë për anulimin e vendimit për lejimin e mjeteve financiare prej 100€ në emër të kujdesit për familjen e ish punëtorit të SHCK, Nr.01-8033/020 të datës 08.10.2002, me 14 vota, kurse 14 ishin kundër, por ky vendim u aprovua me votën e dyfishtë të kryesuesit të Kuvendit ( 15 vota ishin për anulim të këtij vendimi).

9. Anulimi i vendimit 01.Nr.3374 të datës 30.03.2009, për mbështetjen financiare të kandidatëve që përgatisin disertacionin e doktoraturës.

Bujar Nevzadi- ne këtë temë e kemi biseduar edhe në KPF dhe në Komitetin e Arsimit , por kemi biseduar edhe në Drejtorinë e Arsimit. Ne më herët kur kemi pasur mjete ka qenë e arsyeshme ( në vitin 2009) dhe prej vitit 2009 kanë qenë 5 kërkesa të cilat i kemi kompensuar. Mirëpo këtë vit i kemi 4 kërkesa, por në bazë të informatave që i kam unë janë edhe 4 kërkesa të tjera dhe këtë vit do të rritet numri për 8 doktorë të shkencave në Komunë të Gjilanit. Ne mjete nuk kemi dhe për mos t' i krijuar borxhe Drejtorisë së Arsimit kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që të anulohet ky vendim për shkak se nuk posedojmë me mjete të mjaftueshme.

Saranda Bllaca- për këtë pikë ne kemi diskutuar edhe në Komitetin e Arsimit dhe ne anëtarët e LDK-së në këtë komitet kemi qenë për anulim të këtij vendimi. Arsyetimi është i thjeshtë dhe kemi theksuar se nuk jemi kundër për t' i ndihmuar atyre që i mbarojnë studimet e doktoraturës, por jemi më shumë për t' i ndihmuar atyre profileve të cilat ka nevojë më shumë Komuna dhe për profilet që ka mungesë në Komunë dhe të cilët mandej do të japin kontribut në Komunë.

Unë e kam një propozim dhe një ide që të veprojmë ashtu siç kanë vepruar disa shtete fqinje që studentët të cilët i përfundojnë studimet e doktoraturës të shikohet nëse ato universitete janë në listën e top 500 të të gjitha universitet e botës. Listën e universiteteve të top 500 mund ta shohim secili nga ne në faqe të internetit. Kjo është ide e mirë sepse nëse hulumtojmë në këtë faqe do të gjejmë studentë të cilët nuk janë askund në listë.

Arben Maliqi- unë edhe në KPF nuk jam pajtuar dhe kam qenë i vetmi që kam qenë kundër, por mos të harrojmë se i vetmi arsimi ka qenë ai që ka funksionuar paralelisht dhe të vijmë në një gjendje dhe të mendojmë se nuk japim mjete për arsim për mua është shumë absurde. Ne e dimë se në çfarë gjendje jemi por po them: “ të mbjellësh misër dhe grurë ke rendimente për një vjet, të mbjellësh pemë ke rendimente për 15 vjet, por të mbjellësh arsimin do të korrim rendimente për tërë jetën”.

Ajo që e përmendi zonjusha Sarandë, ajo qëndron., unë jam për atë propozim, sepse është shumë propozim i drejtë, mirëpo është shumë diskriminuese për ata të cilët janë në proces dhe t' i anulohet ajo e drejtë është diskriminim i madh. Unë njoh shumë kolegë të cilët janë bazuar dhe kanë menduar në këto të ardhura që do t' i marrin, kurse tash ne i biem në një pozitë të palakmueshme dhe ata të cilët do t' i vazhdojnë studimet e doktoraturës nuk do ta kenë lehtë. Këta njerëz i duhen Kosovës dhe Komunës së Gjilanit, ndërsa sa i përket asaj se çfarë doktrature kanë bërë, të mirë apo të keqe ka kush i vlerëson. Unë edhe njëherë iu kisha lutur mos të bëjmë diskriminime të tilla si jo privat i shtetit etj. Unë iu lus që kur është fjala për arsim të gjithë duhet të jemi unik t' i përkrahim ata të cilët punojnë, sepse ata nesër do të jenë në vendin tonë. Ata janë të cilët i japin dritë këtij populli. Ne duhet t' i përkrahim ata studentë ata djem dhe vajza të cilët janë në këtë proces.

Izmi Zeka- ne në Komitet jemi pajtuar që të kthehet propozimi, kurse ky vendim si është marrë nuk është i dizajnuar mirë, prandaj të kthehet në Komitetin e Arsimit dhe të Kulturës dhe të dizajnohet mirë dhe mandej marrin ndonjë qëndrim për vitin e ardhshëm si të veprojmë? Kështu si është ky vendim edhe mjete nuk ka, por është edhe i mangët.

Arben Maliqi- a është diskriminim ata të cilët kanë marrë, sepse ka këtu përfitues (4-5) vetë kanë marrë, prandaj le të hyjnë edhe të tjerët në proces, kurse nga dita e sotme të

anulohet, ta marrim kështu vendimin. Ata të cilët janë në proces mos t' i bëhet diskriminim?

Izmi Zeka- kush është për anulim të këtij propozim vendimi kështu si figuron tash?

Aprovohet pika 9 e rendit të punës: Anulimi i vendimit 01.Nr.3374 të datës 30.03.2009, për mbështetjen financiare të kandidatëve që përgatisin disertacionin e doktoraturës, me 28 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 5 ishin kundër.

Mirëpo i rekomandohet Komitetit të Arsimit dhe Kulturës që ta dizajnojnë një vendim më profesional dhe t' i propozohet Kuvendit.

10. Anulimi i vendimit për lejimin e marrjes me qira të hapësirave mësimore për student, 01.Nr.16-16499 të datës 09.02.2012,

Izmi Zeka- ky është një vendim për qiramarrje të Kolegjit "Gjilani" të cilin e kemi marrë më herët, por i cili nuk është implemtuar, sepse Rektorati nuk ka shprehur vullnetin që studentët e Universitetit Publik t' i vijojnë studimet në këtë Kolegj, prandaj për mos të mbetur pezull ky vendim, ne sot duhet të marrim vendim për ta anuluar.

Sadudin Berisha- unë mendoj se jo herën e fundit anëtarët e Kuvendit po manipulohen me propozimet të cilat vijnë nga partia në pushtet. Nëse nuk gabojmë vitin e shkuar ish ministri i Arsimit në një debat që e kemi pasur së bashku me përfaqësuesit politik institucional të Komunës, saktësisht është thënë se viti 2011 do të mbyllet me hapjen e një universiteti publik për qytetarët e Gjilanit dhe Anamoravës dhe ai premtim jo që nuk është realizuar, por as që është diskutuar në nivel të Qeverisë së Kosovës.

Për derisa regjioni i Gjilanit përfshin jo vetëm komunat brenda kufirit të saj, por përfshin edhe tri katër komuna tjera teritorialisht që hyjnë në kuadër të Luginës së Preshevës, Preshevë, Bujanoc dhe Medvegj duke përfshirë edhe Komunën e Kumanovës. Mirë që është hapur Universiteti Publik në Pejë me një regjion shumë të kufizuar me një popullatë shumë më të vogël se vetë regjioni i Anamoravës të funksionojë atje, kurse të mos diskutohet fare këtu hapja e universitetit?

Si kërkesë e cila ka qenë shumë e logjikshme dhe e ligjshme e kryetarit të Komunës së bashku me ju dhe që ne e kemi pranuar për ta ndihmuar dhe përsheptuar këtë proces e kemi mbështet nevojën për sigurimin e hapësirë për ushtrimin e funksioneve të hapjes së universitetit. Ajo nuk ndodh, por nuk është problemi tash se duhet apo nuk duhet të anulohet ky vendim, është problemi se asgjë Qeveria e Kosovës nuk ka bërë në Gjilan edhe atë në asnjë fushë të infrastrukturës ku ka të bëjë me investime kapitale siç është rasti me hapjen e Universitetit Publik në Gjilan dhe për nevojat e Anamoravës dhe më gjerë se Anamorava. Për këtë arsye po e them se mos bëni lojëra të tilla të premtimeve e që nuk realizohen, por që edhe juve iu sfidojnë si grupim politik nga partia në pushtet. Gjilani me politikën që ushtrohen sot është kancer i politikave ekonomike edhe politike në tërë Kosovën për shkak të keq menaxhimit të buxhetit atje etj

Ejup Haziri- ne si grup jemi për anulim të vendit, kurse Enver Hoxhajni e kanë larguar nga pozita e ministrit të arsimit dhe e kanë bërë ministër të jashtëm, për shkak se nuk e ka mbajtur fjalën!

Bujar Nevzadi- mua më nxiti z. Sadudini ta marrë fjalën, sepse ai e tha se Qeveria e Kosovës nuk e ka bërë asnjë investim! Mirëpo ai që nuk e sheh se gjëja nuk qenka bërë

asnjë investim, mendoj se ai njeri është i verbër. Kjo nuk qëndron, sepse 7 shkolla të reja janë ndërtuar për këto 5 vjet dhe 4 anekse shkollore dhe gjithsejtë bëjnë 20 mijë m<sup>2</sup> hapësirë shkollore. Sa i përket universiteti janë hapur dy drejtime të reja dhe i kemi ndërtuar edhe 500 m<sup>2</sup> për fakultet. Gjithashtu po shpresojmë se këtë vit do të lirohet edhe Shkolla e Mesme e Bujqësisë dhe do të formohen edhe tri degë të reja, por në vitin e ardhshëm do të hapen edhe degë të tjera të fakultetit, por ato do të hapen ngadalë për të qenë sa më të sigurt.

Sadudin Berisha- unë nuk fola për nivelin e arsimit të Komunës së Gjilanit, por ishte çështje e diskutimit madje me qira e një objekti privat në funksion të hapjes së një Universiteti Publik për Gjilanin dhe për nevojat e Anamoravës. Ky është investim kapital nacional dhe premtimet që janë dhënë as që janë diskutuar as që janë në rend të ditës për t' u diskutuar dhe në emër të këtyre premtimeve boshe kemi marrë aq sa e kemi marrë mbështetjen. Është në interes edhe të opozitës po t' ishte realizuar ai projekt, pa përjashtim, është në interes, sepse ne do ta kërkojmë dhe do ta bëjmë patjetër.

Investimet në shkolla mos harroni se ju e trashëgoni pushtetin për 4 vite nga një pushteti i mëparshëm që gjysma e më tepër e atyre shkollave kanë qenë projekte të cilat kanë filluar për t' u realizuar. Mos i përvetësoni ato që i ka filluar dhe zhvilluar ish pushteti.

Izmi Zeka- nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi kërkon që të deklarohen anëtarët e Kuvendit se kush është për anulim të këtij vendimi?

Nuk aprovohet propozim-vendim për anulim të pikës 10: Anulimi i vendimit për lejimin e marrjes me qira të hapësirave mësimore për student, 01.Nr.16-16499 të datës 09.02.2012, sepse për anulim të vendimit votuan 14 anëtarë të Kuvendit, kurse kundër ishin 16, kështu që vendimi mbetet në fuqi.

Me këto debate seanca e Kuvendit i përfundoi punimet , kurse pika 11 dhe 12 do të shqyrtohen në seancën tjetër.

11. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për raste sociale,
12. Propozim vendimi për uljen e tarifës mbi qiranë për shfrytëzimin e lokalit afarist (Bodrumi-Tombola) në Gjilan

14. Të ndryshme,

Procesmbajtësi

---

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

---

Izmi ZEKA